



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI BASHKIAK TIRANË**

V E N D I M

Nr.117 dt.09.10.2001

**MBI
TRANSPORTIN QYTETAR NE QYTETIN E TIRANES**

Në mbështetje të nenit 10 pika 3, Kap.I, gërma d, të ligjit Nr.8654 dr.31.07.2000 “Për organizimin dhe funksionimin e Bashkisë Tiranë”, Ligjit Nr.8308 dt.18.03.1998 “Për transportin rrugorë” sipas studimeve për këtë qëllim të Parkut të Autobuzave për këtë qëllim të Parkut të Autobuzave Tiranë dhe Drejtorisë së Zhvillimit Ekonomik, me propozim të Kryetarit të Bashkisë Tiranë, Këshilli Bashkiak

V E N D O S I

1. Transporti qytetas në territorin e Qytetit të Tiranës, do të përbëhet nga 9 linja urbane

Linja nr.1	Kombinat – Kinostudio
Linja nr.2/A	Stacioni i Trenit-Tirana e Re
Linja nr.2/B	Shkolla Teknologjike-Flora
Linja nr.3	Unaza e Madhe
Linja nr.4	Qendër Porcelan
Linja nr.5	Sauk-Senatoriumit
Linja nr.6	Kombinati i Autotraktorëve
Linja nr.7	Kamza
Linja nr.8	Lapraka

2. Parku i Transportit Urban të Udhëtarëve Tiranë do të jetë përgjegjës për mbulimin e këtyre linjave urbane

Linja nr.1	Kombinat – Kinosstudio
Linja nr.2/A	Stacioni i Trenit – Tirana e Re
Linja nr.3	Unaza e Madhe

3. Shoqëritë Private të Transportit pas licensimit të tyre sipas procedurave përkatëse ligjore, në Bashkinë e Tiranës, do të jenë përgjegjës për mbulimin e këtyre linjave urbane

Linja nr. 2/B	Shkolla Teknologjike – Flora
Linja nr. 4	Qendër Porcelan
Linja nr. 5	Sauk – Senatoriumit
Linja nr. 6	Kombinati i Autotraktorëve
Linja nr. 7	Kamza
Linja nr. 8	Lapraka

4. Cmimet e biletave për linjat urbane të pikës 2 dhe 3 të këtij Vendimi të jenë konform dispozitave ligjore të ligjit “Për cmimet dhe tarifat”
5. Për zbatimin e këtij vendimi dhe ndjekjen e të gjitha procedurave ligjore në fuqi ngarkohet Drejtoria Juridike, Drejtoria e Përgjithshme e Burimeve Ekonomike dhe Parku i Transportit Urban të Udhëtarëve
6. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë

KRYETARI

Leonidha TOSKA